



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT
Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: “MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE FINANCIARE NË RASTE TË VEÇANTA Z. SAJMIR MEÇA PËR TË MITURIN S.MEÇA”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, VKB-së nr.3, datë 30.01.2026 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2026 dhe PBA përfundimtare 2026-2028”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, ligjin nr. 18/2017 “Për mbrojtjen të të drejtave të fëmijëve”

Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Familja Meço, përbëhet nga katër anëtarë dhe jetojnë në lagjen “Uznovë” Berat, në një banesë private, banesë e përshtateshme për të jetuar. Strukturat e Shërbimit Social, administratori shoqëror pasi administruan kërkesën e z.Sajmir Meça babai i fëmijës, kryhen vizitën në familje dhe vlerësuan nevojat social-ekonomike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Familja prej vitesh trajtohet me shërbime mbështetëse nga Shërbimi Social, si familje në vështirësi ekonomike dhe në përbërje fëmijë me aftësi ndryshe si pagesën e ndihmës ekonomike, pagesën e aftësisë së kufizuar dhe pagesën e ndihmës personal.

Djali i familjes, i diagnostikuar prej vitesh me encefalopati, paraplegji inferiore i cili paraqet edhe probleme të rënda shëndetësore, herë pas here kërkohet trajtimi i tij spitalor. Ndërkohë, kryefamiljari është i vetmi që siguron të ardhura, të cilat përbëhen nga një pagë minimale, në periudhat kur ai arrin të punojë, si dhe nga pagesa e paaftësisë së djalit. Por për shkak të nevojës së pandërprerë për kujdes ndaj djalit të madh, ai detyrohet shpesh të mungojë ose të lërë punën për periudha të gjata, gjë që sjell rënie të ndjeshme të të ardhurave familjare. Kjo situatë e vendos familjen në kushte të vështira ekonomike dhe e bën të pamundur përballimin e nevojave bazë të jetesës

Familja aktualisht është duke u përballur me vështirësi social-ekonomike por edhe të zhvillimit për djalit i cili kërkon kujdes primar dhe gjatë gjithë kohës duhet dikush të kujdeset. Fëmija nuk mund të kryej asnjë nevojë dhe të plotsojë nevojat bazike, kërkohet patjetër një nga prindërit për tu kujdesur apo për të ndjekur terapi pranë Qendrës “Lira”.

Situata Financiare

Në përfundim të verifikimit, u konstatua se familja Meca ndodhet në një gjendje të vështirë social-ekonomike, e cila është përkeqësuar ndjeshëm kohët e fundit si pasojë e problemeve shëndetësore të nënës, kujdesit ndaj djalit me aftësi të kufizuara dhe mungesës së të ardhurave të qëndrueshme. Familja ka nevojë për mbështetje të menjëhershme dhe të vazhdueshme nga strukturat përkatëse të bashkisë për të përballuar situatën aktuale ***propozojmë që z.Sajmir Meço të mbështetet në masën 80.000 (tetëdhjetë mijë) lekë .***

Drejtoria / Sektori përgjegjës

Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimit Social.

A është objekt i konsultimit publik:

Ky material nuk është objekt i konsultimit publik

Komisioni i Përhershëm për “ **Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**” , i mbledhur në datën 27/02/2026, shqyrtoi projekt vendimin “**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE FINANCIARE NË RASTE TË
VEÇANTA Z. SAJMIR MEÇA PËR TË MITURIN S.MEÇA”**

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve në raste të veçanta, për shtetasin Sajmir Meço në shumën 80.000 (tetëdhjetë mijë) lekë .
2. Shuma prej 80.000 (tetëdhjetë mijë) lekë do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2026.

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale

Krenar Suku- Kryetar i Komisionit

Anisa Veliu –N/Kryetar

Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit

Fatjon Elezi-Anëtar

Rovena Cuku-Anëtar

Muharem Hoxha-Anëtar

Shyqyri Dura-Anëtar

Datë 27/02/2026